



Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve, si dhe nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

V E N D I M

I. Për themelimin e Komisionit Punues për shqyrtimin e kërkesave, përkatësisht lëndëve të pranura nga Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për trajtimin-legalizimin e ndërtimeve pa leje për objektet e kategorisë së II-të, të cilat nuk janë shtëpi banimi.

II. Komisioni Punues themelohet në përbërje prej:

1. Hasim Vishesella, kryesues
2. Hasan Hajdini, anëtar
3. Enver Elshani, anëtar

III. Detyrat e Komisionit Punues

Komisioni Punues inspekton kërkesat themelore për shëndet dhe siguri në punë në përputhje me Ligjin Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve, duke përfshirë:

1. Gjendjen ekzistuese të objektit dhe krahasimin me dokumentacionin e dorëzuar;
2. Strukturën/elementet konstruktive të ndërtesës;
3. Rrjetin e ujit dhe kanalizimit;
4. Elektrikës;
5. Instalimet makinerike; dhe
6. Masat mbrojtëse kundër zjarrit.

Kërkesat themelore sipas nr. rendor 1 dhe 2 inspektohen nga Kryesuesi i Komisionit, kurse kërkesat tjera nga anëtarët tjerë të Komisionit varësisht prej profileve profesionale.

Pas inspektimit të kërkesave, secili nga anëtarët e Komisionit Punues plotëson pjesën e caktuar të Shtojcës 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.06/2019 për kërkesat themelore për shëndet dhe siguri, procedurat dhe dokumentacionin për trajtimin e ndërtimeve pa leje të kategorisë I dhe II të ndërtimeve.

IV. Mandati i Grupit Punues do të jetë deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesave në përputhje me Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.

V. Ky Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Me këtë Vendim njoftohen:

Anëtarët e Komisionit Punues dhe
DPUMM

01 Nr. 020/06-18105
Lipjan, më 06-04-2022



Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës